



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 36, datë 09. 10. 2012

PËR

“RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIN E PAGAVE TË QENDRËS KULTURORE “TIRANA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8 pika 1/I, gërmat “b” dhe “c” dhe pika 1/II, gërmat “a” dhe “c”, nenit 10 pika 3/II, nenit 32, gërma “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neneve 111, 113, 124 dhe 125 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; (i ndryshuar); ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 për “Artin dhe Kulturën”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 3.4.1993 për “Kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.09.2006 për “Kalimin e Kinemave “Dajti”, “Agimi” dhe “Lapraka” në varësi të Qendrës Kulturore “Tirana”, një ndryshim në strukturën dhe buxhetin e saj, si dhe transferimin e aktiveve të qëndrueshme, qarkulluese dhe detyrimeve debitoare e kreditore të administratës së kinemave, sipas bilancit të datës 31.03.2006, në Qendrën Kulturore “Tirana”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë riorganizimin e strukturës organizative të “Qendrës Kulturore Tirana”, sipas organigramës bashkëlidhur me një numër total punonjësish 42, si dhe nivelin e pagave të punonjësve sipas lidhjes nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës 1, të ndryshohet destinacioni i objektit ish kinema “Dajti”, në qendër multifunktionale me emrin TEN në administrim të “Qendrës Kulturore Tirana”.
3. Kalimin pranë Qendrës Kulturore “Tirana”, të vlerave kapitale të investimit të bërë nga Bashkia për shndërrimin e saj në qendër multifunktionale si më poshtë:

| | |
|---|-------------------------|
| Rikonstruksioni i ndërtesës, | 15.914.182 lekë, |
| Mobilim, pajisje dhe instalimi i kondicionimit, | 6.866.988 lekë. |
| Shuma TOTALE | 22.781.170 lekë, |

4. Pika 2 gërma “e” e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësi të Bashkisë së Tiranës, përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë”, si dhe pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 10.11.2011, për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, revokohen.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Qendra Kulturore “Tirana”.
6. Ky vendim hyn në fuqi në datën 01 janar 2013.

K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI